I

# VLERSIMI TË NDIKIMIT NË MJEDIS

# PËR FABRIKËN E PRODHIMIT TË PRODUKTEVE NGA QUMSHTIT

Babush, Ferizaj

**PËRMBAJTJA:**


1. HYRJE....7
2. KORNIZA LIGJOR PËR HARTIMIN E RAPORTIT TË VNM-së....8
3. PËR KOMPANINË....8
   a) Vendndodhja e Fabrikës....9
   b) Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit....14
   c) Përshkrimi i veçorive kryesore të fazës operative të projektit....13
   d) Lënda e pare dhe lënda ndihmëse....15
   e) Përshkrimi detal i procesit teknologjik....16
   f) Përllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit....22
4. PËRSHKRIMI I ALTERNATIVAVE TE ARSYESHME....25
5. GJENDJA AKTUALE E MJEDISIT....26
   5.1 Menaxhimi i ajrit....27
   5.2 Hidrografia....24
   5.3 Menaxhimi i mbeturinave....25
6. IDENTIFIKIMI DHE PËRSHKRIMI I NDIKIMEVE NË MJEDIS....26
   6.1. Ndikimet në ajër....27
   6.2. Ndikimet në tokë....28
   6.3. Ndikimet në ujë....28
   6.4. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë....29
   6.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë....29
   6.6. Ndikimet nga zhurma....29
   6.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore....30
   6.8. Ndikimi mjedisor nga mbeturinat....30
   6.9. Trashëgimia Kulturore....31
7. PËRSHKRIMI I PASOJAVE TË MUNDËSHME NË MJEDIS....32
PËRSHKRIMI I METODAVE PËR VLERËSIMIN E PASOJAVE MJEDISORE....33
9. PERSHKRIMI I MASAVE....36
   9.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër....36
   9.2. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në tokë....37
   9.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë....37
   9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma....38
   9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë....39
   9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë....40
   9.7. Masat për menaxhimin e mbeturinave....41
   9.8. Masat rehabilituese....42
   9.9 Komponentë mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve....43

10. PËRSHKRIMI I PASOJAVE NEGATIVE MJEDISORE ........................................ 43
11. MONITORIMI DHE RAPORTIMI ........................................ 44
12. PËRFUNDIM ........................................ 45
13. KOSTOJA INVESTIVE ........................................ 47
14. LITERATURA E PERDORUR ........................................

**Lista e Figurave**

Figura 1. Ortofoto e shtrirjes së lokacionit ku është duke u ndërtuar fabrika ........................ 10
Figura 2. Topografia e shtrirjes së lokacionit ku është duke u ndërtuar fabrika ........................ 10
Figura 3. Distanca e kompanisë me operatorët e tjerë ekonomik ........................ 11
Figura 4. Topografia e rrjetit ujor ........................ 12
Figura 5. Pasteri për pasterizimin e qumështit ........................ 17
Figura 6. Paster me Homogjizator për pasterizimin e ajkës dhe homogjinizimin ........................ 20
Figura 7. Rrjeti Hidrografik i lokacionit të fabrikës ........................ 26
Figura 8. Dukaj e Impiantit të trajtimit të ujit ........................ 36
Figura 9. Kontejnerët e Mbeturinave ........................ 40

**Lista e Tabelave**

Tabela1-të dhënat për lënden e pare-qumshtin ........................ 16
Tabela 2. të dhënat statistikore të krijimit të metjeve urbane për kokë banori ........................ 27
tTabela-3. Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut **shtetëror ........................ 31**
Tabela-4 Kostoja investive e fabrikës ........................ 47

| | |
|---|---|
| Investitori : | **INVESTITORI:**<br>"ANOR"SH.P.K.<br>Babush-Ferizaj<br>Burhan Xhaferi -Drejtor<br>________________<br>v.v |
| Emërtimi i projektit | RAPORT<br>I<br>VLERSIMI TË NDIKIMIT NË MJEDIS<br>PËR FABRIKËN E PRODHIMIT TË PRODUKTEVE NGA QUMSHTIT<br>Babush, Ferizaj |
| Lokacioni : | Babush, Ferizaj<br>P-72209079-00 241-4 |
| Hartuesit e Raportit të VNM-s | 1. Menderes Halabaku inxh.dipl.i gjeol. |

**Republika e Kosovës**
**Republika Kosova-Republic of Kosovo**
***Qeveria –Vlada-Government***
**Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor**
**Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja**

Në bazë të nenit 16 paragrafit 1 të Ligjit për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr 03L/214 dhe Udhëzimi Administrativ për Licencim të Hartuesëve të Raporteve për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.10/2017, për Hartues të Raporteve të VNM, Ministri i MMPH lëshon:

Nr. i licencës: 46/19

# LICENCË

Menderes HALABAKU, Inxhinier i Diplomuar i Gjeografisë

Licencohet si person fizik për hartimin e raporteve të VNM-së

**Data e vlefshmërisë:**
**12.08.2019— 12.08.2024**
**Prishtinë**

**Fatmir Matoshi**

**Ministër i MMPH-së**

Republika e Kosovës
Republika Kosova-Republic of Kosovo
Qeveria -Vlada-Government

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor
Ministarstvo Sredine i Prostornog Planiranja
Ministry of Environment and Spatial Planning

## FORMULAR PËR KËRKESA

| | | |
|---|---|---|
| Kërkesë për: | Përshkrim i shkurtër i kërkesës | PO |
| | Kërkesë për vazhdimin e licencës për hartimin e raporteve për VNM-të | |
| VËREJTJE | | |

| | |
|---|---|
| Emri dhe mbiemri i palës, adresa | Mendores Halabaku<br>Bzhaqau Viti |
| Numri i telefonit<br>E-mail | 044 194 474<br>mendoresh@yahoo.com |
| Numri i mobilit | 044194474 |
| Nënshkrimi i palës | Mendores Halabaku |

Sekretari i Përhershëm,
e-mail: zipm_maph@yahoo.com
Tel: ++381 38 200 32 010, Fax: ++381 38 517 800, Rruga Nazim Gafurri 31, Prishtinë

| | |
|---|---|
| 1. Hyrje | Hartimi i Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të produkteve nga qumështit është një kërkesë e cila del nga **Ligji nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis**, për t'u siguruar që kompania **"ANOR" Sh.p.k.**, e cila ushtron aktivitetin e saj në **zonën kadastrale të Babushit, Komuna e Ferizajit**, të veprojë në përputhje me standardet mjedisore të vendosura nga legjislacioni vendor dhe ai ndërkombëtar për mbrojtjen e mjedisit. Kjo përfshin respektimin e normave për ndotjen e ajrit, trajtimin e ujërave të ndotura, menaxhimin e mbetjeve organike, si dhe mbrojtjen e burimeve ujore dhe tokësore.<br>Raporti i Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis përbën një dokument të rëndësishëm dhe të domosdoshëm për marrjen e Pëlqimit Mjedisor, duke qenë se aktivitetet e fabrikës gjatë procesit teknologjik të pranimit, pasterizimit, fermentimit, përpunimit dhe ambalazhimit të produkteve nga qumështit, gjenerojnë potencialisht ndotës të ndryshëm që duhet të vlerësohen për ndikimin e tyre mbi ajrin, ujin dhe tokën. Përmes këtij raporti të VNM-së do të përkufizohen të gjitha ndikimet që mund të paraqiten nga funksionimi i fabrikës, duke marrë në konsideratë mjedisin jetësor të ngushtë dhe të gjerë. Hartimi i raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis bëhet me qëllim që në mënyrë transparente të paraqitet ndikimi në mjedis për fabrikën e prodhimit të produkteve nga qumështit, në mënyrë që të mundësohet ruajtja e mjedisit dhe zhvillimi i qëndrueshëm industrial. Ky vlerësim i ndikimit në mjedis është punuar duke u bazuar në kërkesën e operatorit, gjendjen aktuale të lokacionit, karakteristikat e zonës, gjendjen ekzistuese të mjedisit rreth fabrikës, si dhe dokumentacionin teknik të ofruar.<br>Detyra e përgatitjes së këtij raporti të VNM-së ka për qëllim identifikimin e burimeve të ndotjes, vlerësimin e ndikimit të tyre në mjedis, si dhe propozimin e masave për parandalimin apo zvogëlimin e ndikimeve negative deri në kufijtë e lejuar ligjorë. Të gjitha konstatimet dhe rekomandimet që dalin |

| | |
|---|---|
| | nga ky raport do të shërbejnë si udhëzues gjatë fazës së operimit, duke garantuar që aktiviteti i kompanisë të jetë në harmoni me ruajtjen e mjedisit dhe mbrojtjen e shëndetit të komunitetit. |
| 2.Baza ligjor për hartimine raportit të VNM-së | Bazuar në karakteristikat e fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit, ku ky projekt është subjekt i vlerësimit të ndikimit në mjedis. Ligji Nr. 08/L-181 për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis i cili është baza kryesore ligjore te cilit ju kemi referuar. Shtojca 1 e këtij ligji, paragrafi 8: Për përgatitjen e këtij raporti janë konsultuar edhe ligje të tjera relevante, si:<br>**Ligjet:**<br>• Ligji për Mbrojtjen e Mjedisit Nr. 03/L-025;<br>• Ligji për Vlerësimin e Ndikimit në Mjedis Nr.08/L-181;<br>• Ligji për Mbeturina Nr. 04/L-060;<br>• Ligji nr. 08/l-071 për ndryshimin dhe plotësimin e ligjit nr.04/l-060 për mbeturina<br>• Ligji për Planifikim Hapësinor Nr. 04/L-174;<br>• Ligji për Mbrojtjen nga Zhurma Nr. 02/L-102;<br>• Ligji për Ujërat e Kosovës Nr. 04/L-147;<br>• Ligji për Mbrojtjen e Ajrit nga Ndotja Nr. 08/L-025;<br>• Ligji për Mbrojtjen e Natyrës Nr.03/L-233;<br>• Ligji për Mbrojtje nga Zjarri Nr. 08/L-261.<br>**Udhëzimet Administrative:**<br>➢ Udhëzim administrativ Nr 04/2025 për "Përmbajtjen, metodologjinë dhe përputhshmërinë e raportit me kërkesat ligjore, praktikat e zbatueshme dhe aspektet e tjera teknike të raportit"<br>➢ Udhëzim administrativ Nr.13/2013 për Katalogun Shtetëror të Mbeturinave; |

| | |
|---|---|
| | ➢ Udhëzimit Administrativ (QRK) Nr. 07/2021 për rregullat dhe normat e shkarkimeve në ajër nga burimet e palëvizshme të ndotjes;<br>➢ Udhëzimi administrativ Nr.02/2022 për kushtet, mënyrat, parametrat dhe vlerat kufizuese te shkarkimit të ujërave të ndotura në rrjetin e kanalizimit publik dhe në trupin ujor;<br>Pasi që për këtë veprimtari është e nevojshme të bëhet vlerësimi i ndikimit në mjedis (VNM), atëherë për të adresuar ndikimet mjedisore të mundshme, masat për zvogëlimin e ndikimeve dhe përputhshmërinë ligjore, investitori ka vendosur që të kryej një studim përkatës të vlerësimit të ndikimit në mjedis, të përgatis raportin dhe të aplikon për pëlqim mjedisor në Ministrinë e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor (MMPH). |
| 3.Të dhënat për kompaninë | Kompania **"ANOR" SH.P.K.** është themeluar në vitin 2019 në Babush-Ferizaj dhe ka për qëllim zhvillimin e aktivitetit në fushën e prodhimit të produkteve nga qumështit dhe nënprodukteve të tij. Aktiviteti kryesor i kompanisë përfshin pranimin, pasterizimin, përpunimin, fermentimin dhe ambalazhimin e produkteve nga qumështit, duke siguruar produkte cilësore për tregun vendor dhe rajonal.<br>Ky objekt është projektuar sipas standardeve teknike dhe mjedisore bashkëkohore, me synim që të garantojë kushte të përshtatshme për zhvillimin e proceseve teknologjike të prodhimit, si dhe për të siguruar mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik. Tashmë kjo kompani ka të punësuar gjithsej 15 punëtor, dhe me rritjen e kapacitet do shtohen edhe 10 punëtorë të rinjë.<br>Vendndodhja e Fabrikës<br>Ndermarrja private "ANOR" SH.P.K. e formuar dhe e legalizuar pas luftës e njohur edhe ma gjer me kët veprimtari(Prodhimin e djathit dhe te produkteve nga qumështit) gjendet për gjatë rrugës Ferizaj Prishtinë ngastrën katastrale<br>**P-72209079-00 241-4 zk Babush i serbëve.** |

| | |
|---|---|
| | kopja e planit lëshu nga Drejtoria për kadastër në Ferizaj me nje siperfaqe prej 27ari e 90m².   |

*Fig 1 ortofoto e lokacionit të fabrikës*




*Fig 2 Topografia e lokacionit të fabrikës*

Distanca më e vogël midis fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit dhe zonës së banimit, respektivisht shtëpive më të afërta, është mjaft larg sepse rreth fabrikës në një diametër pre 500 m nuk ka shtëpi banimi por vetëm objekte afariste. Kjo largësi konsiderohet e mjaftueshme dhe në përputhje me praktikat e rekomanduara për zonimin industrial, duke siguruar një nivel të pranueshëm mbrojtjeje për komunitetin përreth. Vendosja e fabrikës në këtë distancë ndihmon në minimizimin e ndikimeve potenciale që mund të vijnë nga aktivitetet e saj operative, siç janë emetimet akustike (zhurma), gjenerimi i pluhurit apo lëvizja e mjeteve transportuese. Kjo diferencë hapësinore ofron një zonë tampon mbrojtëse, e cila kontribuon në ruajtjen e cilësisë së jetës për banorët e afërt dhe në të njëjtën kohë përforcon parimet e zhvillimit të qëndrueshëm industrial, duke harmonizuar nevojat për zhvillim ekonomik me mbrojtjen e mjedisit dhe shëndetit publik.



Fig 3 ortofoto e lokacionit të fabrikës tregon distancat nga objektet tjera afariste

Lokacioni ku është duke u ndërtuar fabrika për prodhimin e produkteve nga qumështit karakterizohet nga një distancë e konsiderueshme nga trupat ujorë dhe zonat me vlerë të veçantë natyrore. Fabrika ndodhet rreth 643 metra larg lumit Mirashit të bashkuar me lumin e Nerodimes, kurse rrjedhë tjetër ujore nuk ka në këtë lokacion. Këto distanca tregojnë se projekti nuk ndodhet në afërsi të menjëhershme të shtretërve lumorë, çka minimizon rrezikun e ndikimeve të drejtpërdrejta në ekosistemet ujore dhe në cilësinë e ujit sipërfaqësor. Gjithashtu, nuk ka zona të mbrijtuna me ligj në njëdistancë të madhe nga lokacioni i fabrikës. Kjo diferencë



*Fig 4 Topografia e lokacionit të fabrikës që tregon rrjetin ujor të rrethinës*

hapësinore siguron mbrojtjen e biodiversitetit dhe ruajtjen e habitateve natyrore, duke përforcuar bindjen se ndërtimi dhe funksionimi i fabrikës nuk paraqet rrezik të drejtpërdrejtë për resurset natyrore të mbrojtura. Fabrika ndodhet në zonën industrial të përcaktuar nga komuna e Ferizajit.

**Përshkrimi i veçorive kryesore Fizike të Projektit**

Projekti i kompanisë **"ANOR" SH.P.K.** përfshin një kompleks industrial të dedikuar për përpunimin e produkteve nga qumështit dhe nënprodukteve të tij, i cili është i lokalizuar në zonën industriale të Komunës së Ferizajt (zone industrial në këtë lokacion konsiderohet distanca 15 m nga mesi I rrugës magjistrale në të dyja anët e rrugës). Kompleksi është i përbërë nga dy objekte ndërtimore, njeri objekt është ekzistuese i cili i posedon te gjitha lejet , dhe objekti i ri i cili është ne procedura te ndërtimit.

**Objekti ekzistues (dy objekte)-** ka një sipërfaqe ndërtimore prej 1000 $m^2$ dhe ka është i dedikuar kryesisht proceseve bazike të pranimit, pasterizimit dhe përpunimit fillestar të qumështit. Ky objekt përfshin gjithashtu hapësirat ndihmëse për magazinimin e lëndës së parë, dhomat e teknologjisë, si dhe ambientet për stafin Teknik të cilat jan të domosdoshme apo obligative për këtë biznes.

- Zyra për menaxhimin e prodhimit dhe logjistikës.
- Dhoma për stafin (zhveshtore, garderoba, dushe dhe tualete).
- Hapësira për kontrollin e cilësisë dhe laboratori.

Objekti është tashmë në procedurat e ndërtimit dhe përbëhet nga këto elemente kryesore konstruktive:

- **Dyshemeja** është e realizuar me beton i armuar, e përforcuar për të përballuar ngarkesat e mjeteve të rënda dhe pajisjeve industriale, dhe e trajtuar me shtresë epoksit për të siguruar rezistencë ndaj konsumit dhe për të lehtësuar pastrimin.
- **Konstruksioni mbajtës i kulmit** është i përbërë nga strukturë metalike, e projektuar për qëndrueshmëri mekanike dhe rezistencë ndaj kushteve atmosferike.
- **Mbulesa e kulmit** është realizuar me panelet sandwich, të cilat ofrojnë izolim termik dhe mbrojtje nga humbjet e energjisë.

- **Muret anësore** janë të ndërtuara me blloqe betoni, që sigurojnë izolim dhe mbrojtje strukturore, ndërsa kolonat mbajtëse janë gjithashtu prej betoni të armuar, duke garantuar stabilitet të lartë konstruktiv.

Ky objekt është I projektuar për punë biznesore dhe ofron efikasitet maksimal duke plotësuar standardet mjedisore njëherit edhe minimizon ndikimet e mundëshme në tokë ujë dhe ajër.

- **Holli apo vëndi ku jan vendosur pajimet teknologjike** - Linjat e pasterizimit dhe homogjenizimit, Pajisje për ndarje dhe standardizim të përmbajtjes së yndyrës, Linja për fermentimin dhe prodhimin masës so ngjizur apo kosit, kremit dhe produkteve të fermentuara, Seksione të veçanta për prodhimin e djathërave (enë për ngjizje (mpiksje), presa, dhoma për tharje dhe maturimi fillestar).

- **Zona e ambalazhimit dhe magazinimit të produkteve finale** - Linja automatike për mbushje dhe paketim (qumësht, krem, djathë), Magazinë e ftohtë për ruajtjen e produkteve të gatshme, Hapësira për ngarkim-shkarkim të produkteve me mjete transportuese.

- **Hapësirat ndihmëse dhe teknike** - Magazinë për materialet e paketimit (ambalazhe, etiketa, kartonë), Zona për pastrimin dhe dezinfektimin e pajisjeve, Sisteme ndihmëse: dhoma teknike për bojlerë, kompresorë ajri, frigoriferë industrialë dhe pajisje elektrike.

**Lënda e pare dhe lënda ndihmëse**

**Lënda e parë** që përdoret në procesin prodhues të fabrikës **“ANOR” Sh.P.K.** është **qumështi i freskët**, i cili sigurohet nga qumështoret vendore te cilat janë te certifikuara. Cilësia e qumështit është vendimtare për produktet përfundimtare. Qumështi i freskët transportohet në fabrikë në

| | |
|---|---|
| | cisterna të posaçme dhe ruhet në rezervuarë të ftohur për të garantuar stabilitetin mikrobiologjik dhe cilësinë fiziko-kimike deri në përpunim.<br>**Lëndët ndihmëse** janë: kulturat bakteriale, enzimat, kripa, stabilizuesit, aromat, materialet e paketimit, uji dhe kimikatet e pastrimit.<br>**Uji** – përdoret për larjen e makinerive dhe për përgatitjen e disa produkteve sipas nevojës.<br>**Energjia elektrikë -** siguron funksionimin e pajisjeve teknologjike dhe linjave prodhuese.<br>Të gjitha lëndët e përdorura janë të certifikuara dhe përputhen me standardet ushqimore dhe higjienike, duke siguruar cilësinë dhe sigurinë e produkteve përfundimtare.<br>Kapaciteti i planifikuar i përpunimit të qumështit është rreth 350,000 litra në muaj, që përkthehet në një mesatare ditore prej rreth 15,000 litra në ditë, në varësi të fluksit të furnizimit dhe llojit të produkteve që prodhohen.<br><br>Përshkrimi detal i procesit teknologjik<br><br>Projekti parasheh një fabrike moderne për përpunimin e qumështit dhe prodhimin e artikujve të ndryshëm qumështi, përfshirë djathëra të llojeve të ndryshme, kaçkavall, ajkë dhe gjalpë. Fabrika do të jetë e pajisur me linjë teknologjike bashkëkohore, e projektuar për të garantuar sigurinë ushqimore, efikasitetin energjetik dhe mbrojtjen e mjedisit, në përputhje me standardet vendore dhe ndërkombëtare të industrisë ushqimore.<br><br>**Fazat kryesore të procesit janë si më poshtë:**<br>**1. Pranimi dhe ruajtja e lëndës së parë (qumështit të freskët)** - Qumështi i freskët transportohet në fabrikë me cisterna të destinuar, speciale izotermike dhe shkarkohet në rezervuarë higjienikë të pajisur me sistem automatik ftohjeje të konstruktuar nga materiali inox. Ky sistem siguron stabilitetin mikrobiologjik dhe parametrat fiziko-kimikë të qumështit deri në momentin e përpunimit. |

*Tabela 1-të dhënat për lënden e pare-qumshtin*

**TE DHENAT PER LENDEN E PARE – QUMESHTI**

| DATA E PRANIMIT | LENDA E PARE | TREGUESIT E KONTROLLUAR | VLERA E LEJUAR | REZULTATI |
|---|---|---|---|---|
| ? | | Temperatura, $^{0}$C | 10 | |
| | QUMESHT | Yndyra, % | - | |
| | LOPE | Densiteti, ne 20$^{0}$C jo me pak se | 1.029 | |
| | I | Proteinat, ne % jo me pak se. | 3,2 | |
| | FRESKET | Lenda e thate pa yndyre ne %, jo me pak se. | 8,3 | |
| | | Aciditeti, ne grade Tiorner ($^{0}$T) | 15 – 18 | |
| | | Inhibitoret | Ska | |
| | | | | |

**2. Filtrimi dhe pastrimi paraprak** - Pas pranimit, qumështi i nënshtrohet filtrimit mekanik me qëllim largimin e papastërtive fizike dhe grimcave të huaja, duke siguruar lëndë të parë me cilësi të përshtatshme për përpunimin e mëtejmë.



*Fig 5 Makina(Pasteri) për pasterizimin e qumështit*

**3. Homogjenizimi dhe pasterizimi** - Qumështi kalon fillimisht në homogjenizator, ku grimcat e yndyrës shpërndahen në mënyrë uniforme për të përmirësuar qëndrueshmërinë dhe strukturën e produktit final. Më pas, procesi i pasterizimit realizohet në temperatura të kontrolluara (72–75°C për 15–20 sekonda), duke garantuar eliminimin e mikroorganizmave patogjenë dhe sigurimin e sigurisë ushqimore, njëkohësisht duke ruajtur vlerat organoleptike të qumështit.

**4. Përpunimi teknologjik sipas produktit final** - Pas pasterizimit, qumështi ndahet dhe trajtohet sipas destinacionit teknologjik

| | |
|---|---|
| | Pasterizohet 68 °C per 10 minuta<br>↓<br>Shtohet $CaCl_2$ (qumeshti i dhise)<br>↓<br>Kulture bakteriale<br>↓<br>Mpiksja e qumeshtit ne 32-34 grade C me maja ne sasine qe te mpikset ne 45 –55 minuta<br>↓<br>Prerja e shtalpit ne 2-3 cm ne forme kubesh<br>E leme per 5-10 minuta<br>↓<br>Heqim masen e djathit me kujdes per te future ne forma<br>↓<br>Kullohet me vete presim (kthim te formave)<br>↓<br>Kriposet dhe futet ne fuci<br><br>➢ **Prodhimi i djathërave ( Djath i Bardhë, Trapista, Edam/Edamer, Kackavall, Fetta, Krishka**)- Procesi teknologjik i prodhimit të djathërave (djath i bardhë, trapista, edam/edamer, kackavall, fetta, krishka) fillon me pranimin, filtrimin dhe pasterizimin e qumështit, i cili ftohet dhe përzihet me kultura bakteriale dhe enzimë mpiksëse (Renei apo reneti*) për të arritur koagulimin. Masa e mpiksur (kurdha) pritet dhe ngrohet për të ndarë masën e lëngshme |

(hirrën), pastaj vendoset në kallëpe ku shtypet dhe merr formën e dëshiruar. Pas kësaj, produkti kriposet me tretje kripe kuzhine (NaCl- klorur natriumi) ose me kriposje të drejtpërdrejtë, piqet dhe fermentohet në kushte të kontrolluara të temperaturës dhe lagështisë, për të zhvilluar strukturën dhe shijen karakteristike. Në fund, djathërat paketohen në vakum ose ambalazhe plastike dhe ruhen në depo frigoriferike deri në shpërndarje.

Renei apo reneti* (Reni apo renneti)*-përmbanë kimozinë e cila bënë mpiksjen e qumshtit duke e ndarë at në masën e trashë(Kosi) që formon djathin dhe masën e lëngshme (hirra) e cila largohet.

Llojet e renit(reni shtazor nga stomaku i viçit, reni mikrobiologjik nga këpurdhat dhe reni i modifikuar gjenetikisht e cila është një enzimë kimozë e prodhuar nga mikroorganizma e cila përdoret pothuaj më së shumti.

Përoren edhe enzima tjera(lipazat,proteazat dhe laktaza)

- **Produktet e yndyrës së qumështit (Gjalpë, Cream, Double Cream)** - Procesi teknologjik i prodhimit të produkteve të yndyrës së qumështit (gjalpë, cream, double cream*) bazohet në ndarjen e kremit nga qumështi përmes centrifugimit, pasterizimin(68$^{o}$) e tij për sigurimin e cilësisë higjienike dhe stabilitetit, dhe më pas përpunimin sipas produktit final: për gjalpin kremi tundohet deri sa ndahet gjalpi nga maza, pastaj lahet, kripset dhe formësohet, ndërsa për krem (cream) dhe (double cream) pas pasterizimit dhe homogjenizimit ruhet struktura kremoze e qëndrueshme. Produktet përfundimtare ambalazhohen në mënyrë higjienike dhe ruhen në kushte frigoriferike deri në shpërndarje.

cream, double cream* Në industrinë e djathit, termi "double cream" mund të përkthehet në shqip si "krem i dyfishtë". Ky term i referohet një lloj kremini me përmbajtje të lartë yndyre, zakonisht mbi 48%, i cili përdoret për të bërë djathë ose për të drejtuar potencimin e shijeve në përgatitjet e ndryshme kulinare. Në kontekstin e djathit, "krem i dyfishtë" mund të zbatohet për lloje të veçanta djathi që kanë një teksturë të pasur dhe të butë.

| | |
|---|---|
| | ➢ **Schmand (produkte të fermentuara me krem)** - Procesi teknologjik i prodhimit të Schmand (produkte të fermentuara me krem) konsiston në pranimin dhe pasterizimin e kremit të qumështit për sigurimin e cilësisë higjienike, ftohjen e tij në temperaturë të përshtatshme, shtimin e kulturave bakteriale laktike dhe fermentimin për disa orë derisa kremi të trashet dhe të fitojë shijen karakteristike acidike, pas së cilës ambalazhohet në enë plastike ose qelqi dhe ruhet në kushte frigoriferike deri në konsum.<br>➢ **Mazë (48% yndyrë)** - Procesi teknologjik i prodhimit të Mazës (48% yndyrë) përfshin ndarjen e kremit nga qumështi përmes centrifugimit, pasterizimin e tij në temperaturë të kontrolluar për sigurimin e higjienës dhe stabilitetit, homogjenizimin për të ruajtur strukturën e qëndrueshme kremoze, pastaj ambalazhimin në enë plastike ose qelqi dhe ruajtjen në depo frigoriferike deri në shpërndarje.<br>➢ **Produkte me shtesa (Speca në ajkë / Speca me mazë)** - Procesi teknologjik i prodhimit të produkteve me shtesa (speca në ajkë/speca me mazë) përfshin pastrimin dhe përgatitjen e specave të freskët, përgatitjen e ajkës ose mazës sipas proceseve teknologjike përkatëse, mbushjen e specave me produktin e qumështit, mbylljen dhe ambalazhimin hermetik në kuti plastike ose vakum për të siguruar qëndrueshmërinë, dhe në fund ruajtjen e tyre në kushte frigoriferike deri në konsum. |



*Fig 6 Paster me Homogjizator për pasterizimin e ajkës dhe homogjinizimin*

**5. Formësimi, paketimi dhe ruajtja-** Produktet e përfunduara (djath, kaçkavall, ajkë, gjalpë) i nënshtrohen formësimit dhe paketimit në linja të automatizuara, duke përdorur ambalazhe të përshtatshme ushqimore që garantojnë mbrojtjen higjienike dhe zgjatjen e afatit të ruajtjes. Pas paketimit, produktet ruhen në kushte frigoriferike të monitoruara, në përputhje me standardet e zinxhirit të ftohtë, deri në shpërndarje tek klientët.

Përllogaritja sipas llojit dhe sasisë të mbetjeve dhe emetimeve të pritura gjate fazës së operimit

Gjatë funksionimit të fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit, pritet të gjenerohen lloje të ndryshme mbetjesh dhe emetimesh që lidhen me aktivitetet teknologjike, transportin dhe menaxhimin e materialeve. Kjo përllogaritje ndihmon në menaxhimin e qëndrueshëm të mbetjeve dhe në reduktimin e ndikimeve potenciale mjedisore.

| | |
|---|---|
| | ➢ **Ajri** - Faza operative mund të shkaktojë emetime të gazrave dhe pluhurit për shkak të përdorimit të makinerive përpunuese dhe mjeteve transportuese. Emetimet kryesore përfshijnë dioksidin e karbonit ($CO_2$), oksidet e azotit (NOx), si dhe pluhurin. Menaxhimi i qarkullimit të mjeteve, përdorimi i karburanteve cilësore dhe kontrolli periodik i pajisjeve ndihmojnë në reduktimin e ndikimit të këtyre emetimeve.<br><br>➢ **Uji** - Gjatë operimit të fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit, procesi teknologjik gjeneron ujëra të përdorura dhe të ndotura, të cilat përmbajnë substanca organike dhe mikroelemente të mbetjeve të qumështit. Për të siguruar përputhshmërinë me standardet mjedisore dhe për të parandaluar ndotjen e burimeve ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore, të gjitha ujërat e gjeneruara trajtohen në impiantin e trajtimit të ujërave të ndotura të fabrikës. Ky impiant garanton pastrimin e ujërave përpara shkarkimit në rrjetin publik të kanalizimit, duke eliminuar substancat ndotëse dhe duke ruajtur parametrat fiziko-kimik dhe mikrobiologjik sipas ligjit në fuqi.<br>➢ **Tokë** - Ndikimet mbi tokën gjatë operimit janë minimale dhe lidhen kryesisht me rrjedhje aksidentale të karburanteve dhe lëvizjen e mjeteve transportuese. Mbetjet solide dhe materialet e përdorura grumbullohen dhe depozitohen në hapësira të përcaktuara për të parandaluar ndotjen e tokës dhe degradimin e ekosistemit lokal.<br><br>➢ **Zhurma** - Gjatë funksionimit, niveli i zhurmës është minimal dhe i pranueshëm sipas standardeve ligjore. Zhurma kryesore vjen nga lëvizja e mjeteve, por monitorimi i vazhdueshëm dhe mirëmbajtja e pajisjeve sigurojnë reduktimin e ndikimeve akustike. |

| | |
|---|---|
| | ➢ **Flora dhe Fauna** - Ndikimi në florë dhe faunë gjatë operimit është minimal. Aktivitetet operative zhvillohen brenda hapësirave të përcaktuara, duke shmangur dëmtimin e habitatit natyror dhe ruajtur biodiversitetin lokal.<br><br>➢ **Ndikimet sociale dhe ekonomike** - Ky aktivitet nuk pritet të ketë ndikim negativ mbi komunitetin lokal. Përkundrazi, funksionimi i fabrikës kontribuon në zhvillimin ekonomik të zonës dhe krijimin e vendeve të punës, pa shqetësuar cilësinë e jetës së banorëve. |

| | |
|---|---|
| 4,Përshkrimi I mundësive dhe alternativave te arsyeshme | Duke e pasur parasysh se hapësira ku ndodhet fabrika për prodhimin e produkteve nga qumështit **“ANOR” SH.P.K.** është në përputhje me kriteret e zhvillimit industrial dhe njëkohësisht të sigurojë ruajtjen e shëndetit publik dhe mbrojtjen e mjedisit. Më poshtë do ti japim disa alternativa të kursimit të energjisë dhe të arsyeshme të cilat janë shqyrtuar me qëllim të minimizimit të ndikimeve negative në mjedis dhe shoqëri:<br>➢ **Projekti aktual -** Vendndodhja ekzistuese dhe kapaciteti i planifikuar janë vlerësuar si më të përshtatshmet, duke marrë parasysh infrastrukturën ekzistuese, afërsinë me furnizuesit e lëndës së parë, kushtet higjieno-sanitare dhe qasjen në rrjetin energjetik dhe ujor. Teknologjia e përzgjedhur është moderne, me efikasitet të lartë energjetik dhe me mundësi të integrimit të masave për trajtimin e ujërave të ndotura dhe menaxhimin e mbeturinave.<br>➢ **Zgjedhja e Zonës Industriale -** lokacioni ndodhet në zonë industriale me infrastrukturë të zhvilluar(magjistralja Ferizaj-Prishtinë), ku është e mundur të lidhet lehtësisht me burime të tjera si energjia dhe uji. Zonat industriale ofrojnë zakonisht rrjete të mira transporti, të cilat janë thelbësore për furnizimin me lëndë të para dhe shpërndarjen e produkteve. Afërsia me burime energjie dhe ujë siguron furnizim të qëndrueshëm dhe funksionim të pandërprerë të proceseve teknologjike.<br>➢ **Vend me potencial për energji diellore -** Zona industriale e Ferizajit paraqet një një lokacion të përshtatshëm për zhvillimin e projekteve të energjisë diellore, si në nivelin e shfrytëzimit të vogël (çati industriale) ashtu edhe në kapacitete më të mëdha për prodhimin e energjisë elektrike nga sistemet fotovoltaike. Ky potencial lidhet ngushtë me kushtet klimatike, karakteristikat gjeografike dhe infrastrukturën e zhvilluar energjetike të kësaj zone.Potenciali I zhvillimit të energjisë diellore në vendin tone është I favorshëm duke ditur që vendi ynë Brenda vitit kalendarik sipas statistikave të Entit Hidrometeorologjik ka 2180 orë me diell. |

| | |
|---|---|
| 5.Gjendja aktuale e mjedisit | Gjendja e mjedisit është si rezultat i zhvillimit të pakontrolluar në sektorët industrialë dhe urbanë, planifikimit joadekuat të pajisjeve industriale dhe urbane, teknologjisë së vjetër industriale, teknologjisë joadekuate në disa departamente industriale të resurseve natyrore, infrastrukturës jo adekuate në qytete, shtimi i numrit të automjeteve, ndotja e rrjedhave të ujit për shkak të mungesës së trajtimit të ujërave të zeza, akumulimi i plehrave urbane dhe të ngurta industriale, prerja e pakontrolluar e pyjeve, erozioni i dhe fenomenet e tjera natyrore. Hulumtimet e bëra gjatë dhjetë vjetëve të fundit, edhe pse të pakta, kanë identifikuar burime të ndryshme të ndotjes në Kosovë, që ndikojnë në cilësinë e ajrit, ujit, tokës dhe ekosistemeve. Shumë nga këta ndotës mbesin në mjedis madje edhe pasi që burimet e tyre të jenë eliminuar ose zvogëluar. Që nga fillimi i periudhës tranzitore përpjekjet për zvogëlimin e niveleve të ndotjes kanë qenë të pakta, apo edhe kanë munguar fare. Për më tepër, me rimëkëmbjen graduale të ekonomisë, nivelet e shumë aktiviteteve industriale, bujqësore dhe urbane kanë filluar të rriten. Këtu bëjnë pjesë prodhimi i energjisë elektrike, kryesisht nëpërmjet djegies së thëngjillit në termocentrale të mëdha, (Termocentralet Kosova A dhe B), si dhe gazrat të cilat lirohen nga automjetet e vjetruara. Përveç që kanë shkaktuar ndotje të ajrit, këto degë të industrisë kanë krijuar edhe deponi të mëdha të mbeturinave të ngurta. Edhe industritë tjera të lehta kanë shkaktuar probleme mjedisore. Mjedisi ndotet edhe nga mbetjet urbane dhe të biznesit të vogël, sidomos në periudhën pas luftës so fundit. Shikuar në përgjithësi, popullata ende nuk është vetëdijsuar mjaftueshëm për menaxhimin e mbetjeve urbane dhe të përkujdeset për mjedisin. Kështu, hedhja e mbeturinave dhe derdhja e ujërave të zeza jasht sistemit të kanalizimit në fusha dhe në lumenj bëhet pa ndonjë trajtim(neutralizim) paraprak. Përdorimi i pesticideve pa ndonjë kontrollë në sektorin e bujqësisë, numri i rritur i automjeteve personale dhe komerciale, sidomos në hapësirat më të mëdha urbane, dhe sistemi i ngrohjes së shtëpive private me dru ose thëngjill gjatë dimrit, po ashtu llogariten si ndotës të mjedisit. Pluhuri mund të depërtojë nëpërmjet të reshurave në ujëra nëntokësore dhe në këtë mënyrë të shkaktojë ndotjen e resurseve ujore që janë në përdorim të popullatës. Komuna e Ferizajit për shkak të bizneseve që po shtohen përdit bënë pjesë në komunat me ambient mesatarisht të ndotur |

| | |
|---|---|
| **5.1 Menaxhimi i ajrit** | Në aktivitetin e punës së fabrikës për prodhimin e djathit dhe prodhimeve nga qumshti, ndikim negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit. Në zonën e fabrikës ajri është i pastër.<br>Deri te ndotja mundë të vie për shkak të punëve dhe aktivitetit të punës në fabrikë. Ndotësit janë kryesisht pluhurat që barten me anë të erës gjat kohës ë verës. Gjat punës së prodhimit mundë të ndihen edhe aromë e qumshtit apo e aditivëve gjat procesit të prodhimit por të cilat nuk jan edhe aq irituese prandaj nuk mundë të konsiderohen edhe të dëmshme. Në rast se objektit përpunimit te qumshtit “ANOR”SHPK është ekspozuar ndotjes për shkak të mospastërtisë së dyshemesë mundë të ketë edhe aroma të pa dëshiruara për shkak të fermentimit të mbetjeve . |

| 5.2Hidrografia | Në këtë lokalitet respektivisht ngastrën ku është ndërtuar fabrika nuk ka ndonjë burim të ujrave sipërfaqësore, , këtu ujrat paraqiten vetëm kur kemi të reshura atmosferike. Ndotje të ujit mundë të kemi vetëm nga shpërlarja e trasës gjat të reshurave atmosferike. Lumi I Mirashit I cili bashkohet me lumin e Nerodimës është mbi 600 m.   *Foto 7 rrjeti hidrografik I lokacionit* |
|---|---|

**5.3 Menaxhimi i mbeturinave**

Mbeturinat jan shqetësim I popullates në nivel vendi edhe në komunën e Ferizajit. Migrimi I popullates në drejtim të qendrave urbane ka bërë që të shtohet sasia e mbetjeve urbane të cilat kërkojn menaxhim të mirëfillt në mënyrë që të shmanget ndotja e mjedisit.

*Tabela 2-të dhënat statistikore të krijimit të metjeve urbane për kokë banori*

| Llojet e mbeturinave | Mesatarja ditore kg/banorë |
|---|---|
| Mbeturinat e amvisërisë | 0.255 |
| Mbeturinat komerciale | 0.240 |
| Mbeturinat medicionale | 0.0022 |
| Mbeturinat e ngjyrës dhe hirit | 0.805 |
| Mbeturinat e ndërtimit/shkatërrimit | 0.200 |
| Mbeturina të tjera | 0.350 |
| Total | 1.8 |

Në Ferizaj ka një iniciativë për ndërtimin e një fabrike për trajtimin termik të mbetjeve urbane. Relizimi I këtijë projekti do të ishte I rëndësisë së veçant jo vetëm për Ferizajin por për tër Kosovën.

**6.** Vlerësimi dhe përshkrimi i ndikimeve të mundshme në Mjedis

6.1Ndikimi në Ajër-

Në aktivitetin e punës së fabrikës për prodhimin e djathit dhe prodhimeve nga qumshti, ndikim negativ në mjedis shprehet edhe në ambientin e ajrit. Në zonën e fabrikës ajri është i pastër.

Emetimet atmosferike mund të ndodhin si pasojë e përdorimit të karburanteve për ngrohje, transportit të lëndës së parë dhe produktit të përfunduar. Emetimet kryesore përfshijnë dioksidin e karbonit ($CO_2$), oksidet e azotit (NOx) dhe pluhurin. Për shkak të përdorimit të pajisjeve moderne, filtrave dhe sistemeve të menaxhimit të qarkullimit, ndikimi në ajër vlerësohet si minimal dhe i menaxhueshëm.

Gjat punës së prodhimit mundë të ndihen edhe aromë e qumshtit apo e aditivëve gjat procesit të prodhimit por të cilat nuk jan edhe aq irituese prandaj nuk mundë të konsiderohen edhe të dëmshme. Në rast se objektit përpunimit te qumshtit “ANOR”SHPK është ekspozuar ndotjes për shkak të mospastërtisë së dyshemesë mundë të ketë edhe aroma të pa dëshiruara për shkak të

| | |
|---|---|
| | fermentimit të mbetjeve .<br>**Ndikimi në biodiversitet** – Fabrika ndodhet në një zonë që ka edhe biznese tjera dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në habitatet e florës dhe faunës lokale. Megjithatë, menaxhimi i duhur i mbetjeve dhe kontrolli i rrjedhjeve sigurojnë që ndikimet në ekosistemet përreth të jenë minimale.<br>**Zhurma** – Aktivitetet operative dhe transporti mund të shkaktojnë nivele të ulëta zhurme, të cilat janë brenda kufijve të lejuar sipas standardeve mjedisore. Mirëmbajtja e rregullt e makinerive dhe organizimi i qarkullimit të mjeteve ndihmojnë në minimizimin e shqetësimeve për banorët përreth.<br>**Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Operimi i fabrikës nuk pritet të shkaktojë ndikime negative në komunitetin lokal. Përkundrazi, aktiviteti ka potencial për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, krijimin e vendeve të reja të punës dhe punësimin në zone e rrethinë. |
| 6.2Ndikimet në Ujë- | Ndikime negative në ujë shkaktohen nga masa e thërmuar gjat fazës së prodhimit e cila në kontakt m ujin mundë të shkaktoj ndotje. Kompania për evitimin e këtyre ndotjeve ka basenin e neutralizimit dh në këtë mënyrë evitohet ndotja e ujit. Edhe derivatet dhe vajrat e ndryshme të cilat aksidentalish derdhen në tokë nga makinat të cilat jan në shërbim për grumbullimin e qumshtit ndikojnë në ndotjen ujërave sipërfaqësore kur kemi të reshura atmosferike si dhe ndotjen e ujërave nëntokësore.<br>Gjithashtu në ndotjen e ujërave ndikon pluhuri i cili bartet me anë të ujërave sipërfaqësor. Ndikime tjera negative janë edhe derdhja e ujërave të zeza, mbeturinat e ndryshme, etj. |
| 6.3Ndikimet në tokë | Ndikim negativ në tokë mundë të ketë hudhja e grimcave të mbetura nga procesi i prodhimit dhe në kontakt me tokën mundë të ketë ndonjë reaksion kimik i cili mundë të jetë edhe i dëmshëm. Ndikim negativ mundë të kenë mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjat mirëmbajtjes së makinerisë në repartin e prodhimit si dhe mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike që shkaktohen nga vet njeriu. |

| | |
|---|---|
| | Ndikim të madh negativ mundë të kenë edhe derdhja aksidentale e vajrave lybrifikues të makinerisë mobile , Këto vajra në rast të ndonjë defekti aksidental bien në tokë dhe si të tilla janë shumë të dëmshme për natyrën pasi që edhe koha e dekompozimit të tyre është e madhe. Si ndikime negative kemi humbjen sipërfaqes së tokës brenda kontureve të fabrikës. Si ndikime kemi edhe mbeturinat e ngurta të cilat krijohen gjatë procesit të mirëmbajtjes dhe riparimeve të mekanizmit punues, mbeturinat e ndryshme organike dhe jo organike të cilat i krijojnë punëtorët. |

| | |
|---|---|
| **6.4**. Ndikimet në peizazh, florë dhe faunë | Ndërtimi dhe funksionimi i fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit të kompanisë **"ANOR" SH.P.K.** sjell ndryshime të caktuara në aspektin vizual dhe ekologjik të zonës. Lokacioni ku ndodhet objekti gjendet brenda një zone active industriale, gjë që bën që ndikimet mbi peizazhin natyror të jenë të kufizuara. Duke qenë se ky lokacion nuk përfshin hapësira me vlera të larta natyrore apo peizazhe të mbrojtura, ndikimet vizuale do të konsiderohen të pranueshme. Për më tepër, mbjellja e gjelbërimit dekorativ në hapësirat e jashtme të fabrikës do të kontribuojë në përmirësimin estetik të ambientit dhe integrimin më të mirë të objektit në peizazh. Sa i përket florës dhe faunës, lokacioni i propozuar nuk përfshin zona të mbrojtura dhe nuk ndodhet në afërsi të habitateve me biodiversitet të ndjeshëm. Në këtë lokacion nuk ka ndonjë zone të mbrojtur me ligj sepse ky lokacion I përket një zone të paraparë për zhvillimin e industrisë. Ndërtimet kan bërë që ndikimet mbi faunën do të jenë të dukshme por rreth fabrikës parashihen mbjellje e fidaneve decorative të cilët kan ndikim pozitiv edhe në aspektin vizuel edhe ate estetik, Megjithatë, këto ndikime janë të përkohshme dhe pas përfundimit të ndërtimit nuk do të ketë ndikime negative. Në fazën operative, ndikimet mbi florën dhe faunën janë minimale, pasi aktivitetet industriale të fabrikës nuk përfshijnë përdorimin e substancave kimike të rrezikshme dhe nuk krijojnë kushte që mund të cenojnë ndjeshëm biodiversitetin lokal. Përkundrazi, masat kompensuese si gjelbërimi i hapësirave të jashtme dhe mirëmbajtja e tyre do të kontribuojnë në krijimin e një mikro-mjedisi më të qëndrueshëm dhe estetikisht të pranueshëm. |
| 6.5. Ndikimet në vendbanime dhe popullatë | Ndërtimi dhe funksionimi i fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit mund të shkaktojë ndikime të kufizuara mbi vendbanimet dhe popullatën përreth. Gjatë fazës së ndërtimit, ndikimi kryesor lidhet me zhurmën dhe lëvizjen e mjeteve të transportit, e cila mund të krijojë shqetësime të përkohshme për komunitetin lokal. Megjithatë, këto ndikime parashihen të jenë afatshkurtra dhe të menaxhueshme. Në fazën operative, ndikimet e drejtpërdrejta mbi popullatën do të jenë minimale, |

| | |
|---|---|
| | pasi procesi teknologjik nuk përfshin përdorimin e substancave të rrezikshme dhe nuk gjeneron ndotje të konsiderueshme. Zhurma e vetme e pritshme është ajo që vjen nga lëvizja e mjeteve transportuese për furnizim dhe shpërndarje, e cila gjithashtu konsiderohet e kufizuar dhe e kontrollueshme.Në tërësi, ndikimet e aktivitetit të fabrikës mbi vendbanimet dhe popullatën përreth janë të pranueshme dhe nuk pritet të cenojnë ndjeshëm cilësinë e jetës së komunitetit lokal, duke marrë parasysh edhe masat zbutëse të parapara për menaxhimin e zhurmës dhe transportit. Ndërtimi do të ketë ndikim pozitiv pasi do krijohen vende të reja të punës |
| 6.6. Ndikimet nga zhurma | Puna në fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit, burimi kryesor i zhurmës mundë të vijë nga aktivitetet e makinerive ndërtimore dhe qarkullimi i mjeteve transportuese. Këto ndikime janë të karakterit të përkohshëm dhe të lokalizuara kryesisht brenda zonës së punimeve, duke u zvogëluar me përfundimin e fazës ndërtimore. Në fazën operative, ndikimet akustike do të jenë më të kufizuara dhe do të lidhen kryesisht me lëvizjen e mjeteve transportuese për furnizim dhe shpërndarje të produkteve. Procesi teknologjik i prodhimit të produkteve nga qumështit zhvillohet në ambiente të mbyllura dhe nuk përfshin pajisje që gjenerojnë nivele të larta zhurme, prandaj ndikimi i përgjithshëm mbi mjedisin akustik pritet të jetë i ulët. |
| 6.7. Ndikimet në raste të aksidenteve mjedisore | Rastet e aksidenteve mjedisore, ndonëse të rralla dhe të paparashikuara, mund të paraqesin rrezik për mjedisin dhe shëndetin e popullatës përreth fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit të kompanisë **“ANOR” SH.P.K.**. Potencialisht, aksidente të tilla mund të lidhen me rrjedhje aksidentale të karburanteve ose vajrave nga mjetet transportuese, defekte teknike në sistemet e ngrohjes apo në impiantin e trajtimit të ujërave, si dhe zjarre të mundshme në hapësirat teknike apo magazinore.<br>Nëse këto situata ndodhin, ndikimet e mundshme në mjedis mund të përfshijnë ndotjen e tokës dhe ujërave nëntokësore, ndotjen e ajrit nga emetimet e padëshiruara, si dhe rrezikun për sigurinë dhe |

<table>
<tr><td></td><td>shëndetin e punëtorëve dhe popullatës përreth. Gjithsesi, duke qenë se procesi teknologjik i kompanisë nuk përfshin përdorimin e substancave kimike të rrezikshme apo materialeve me rrezikshmëri të lartë, potenciali i këtyre aksidenteve mbetet i kufizuar dhe i menaxhueshëm.</td></tr>
<tr><td>6.8. Ndikimi mjedisor nga mbeturinat</td><td>Gjatë funksionimit të fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit të kompanisë "ANOR" SH.P.K., e cila ndodhet në zonën kadastrale Babushi i serbëve komuna e Ferizajt, gjenerohen mbeturina të ndryshme komunale, të cilat klasifikohen sipas kodeve të Katalogut Shtetëror të Mbeturinave, në përputhje me kërkesat e Ligjit për Mbeturinat Nr. 04/L-060 dhe ndryshimet e mëvonshme.<br><br>Tabela 3. Paraqitja e mbeturinave sipas katalogut shtetëror
<table>
<tr><th colspan="4">Mbeturinat sipas katalogut shtetëror</th></tr>
<tr><th>Numri sipas katalogut shtetëror të mbeturinave</th><th>Emri i Mbeturinës</th><th>Shkalla e rrezikshmërisë</th><th>Lloji I planifikuar për deponimi të mbeturinave</th></tr>
<tr><td>15 01 01</td><td>Ambalazh letre dhe kartoni</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
<tr><td>15 01 02</td><td>Amalazhe plastike</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
<tr><td>20 01 08</td><td>Mbeturinat e najllanit</td><td>Jo të rrezikshme</td><td>Kontejner për mbeturina</td></tr>
</table></td></tr>
<tr><td>6.9. Trashëgimia Kulturore</td><td>Sipas hulumtimit të dokumentacionit përkatës dhe verifikimeve të kryera në terren, si dhe në bazë të informacionit të siguruar nga autoritetet komunale të Ferizajt, rezulton se në afërsi të lokacionit ku është duke u ndërtuar fabrika për prodhimin e produkteve nga qumështit nga kompania "ANOR" SH.P.K., nuk ekzistojnë monumente kulturore, historike apo natyrore të mbrojtura që mund të preken drejtpërdrejt nga zhvillimi i këtij projekti pork y projekt gjendet në lokalitetin i cili mban statusin e zonës industriale.<br>Për rrjedhojë, ndërtimi dhe funksionimi i fabrikës nuk pritet të shkaktojë ndikime negative mbi</td></tr>
</table>

| | |
|---|---|
| | trashëgiminë kulturore dhe natyrore në zonë, duke ruajtur integritetin dhe vlerat ekzistuese të saj. |

| | |
|---|---|
| 7. Përshkrimi i pasojave të mundëshme në mjedis | Fabrika për prodhimin e produkteve nga qumështit nga kompania **"ANOR" SH.P.K.** mund të ndikojë në mjedis në mënyra të ndryshme gjatë fazës operative. Pasojat potenciale janë kategorizuar sipas komponentëve mjedisorë për një vlerësim të qartë dhe të menaxhueshëm:<br><br>• **Ndotja e ajrit** – Emetimet atmosferike mund të ndodhin si pasojë e përdorimit të karburanteve për ngrohje, transportit të lëndës së parë dhe produktit të përfunduar. Emetimet kryesore përfshijnë dioksidin e karbonit ($CO_2$), oksidet e azotit (NOx) dhe pluhurin. Për shkak të përdorimit të pajisjeve moderne, filtrave dhe sistemeve të menaxhimit të qarkullimit, ndikimi në ajër vlerësohet si minimal dhe i menaxhueshëm.<br><br>• **Ndotja e ujërave** – Ujërat e përdorura nga proceset e përpunimit të qumështit trajtohen në impiantin e përpunimit të ujërave të ndotura përpara shkarkimit në rrjetin publik. Rreziku kryesor lidhet me rrjedhje aksidentale të karburanteve ose vajrave nga mjetet transportuese dhe makineritë operative. Implementimi i sistemeve të trajtimit të ujërave dhe masave parandaluese siguron përputhshmërinë me standardet ligjore dhe minimalizon ndikimin mbi burimet ujore sipërfaqësore dhe nëntokësore.<br><br>• **Ndotja e tokës** – Kontaminimi i tokës mund të ndodhë për shkak të rrjedhjeve të mundshme të vajrave dhe karburanteve, si dhe nga menaxhimi i gabuar i mbetjeve të prodhuara gjatë operimit. Për shkak të betonizimit të sipërfaqeve operative dhe përdorimit të kontejnerëve të mbyllur për mbeturinat, ndikimi në tokë vlerësohet minimal dhe i menaxhueshëm. |

| | |
|---|---|
| | • **Ndikimi në biodiversitet** – Fabrika ndodhet në një zonë që ka edhe biznese tjera dhe nuk ndikon drejtpërdrejt në habitatet e florës dhe faunës lokale. Megjithatë, menaxhimi i duhur i mbetjeve dhe kontrolli i rrjedhjeve sigurojnë që ndikimet në ekosistemet përreth të jenë minimale.<br><br>• **Zhurma** – Aktivitetet operative dhe transporti mund të shkaktojnë nivele të ulëta zhurme, të cilat janë brenda kufijve të lejuar sipas standardeve mjedisore. Mirëmbajtja e rregullt e makinerive dhe organizimi i qarkullimit të mjeteve ndihmojnë në minimizimin e shqetësimeve për banorët përreth.<br>• **Ndikimet sociale dhe ekonomike** – Operimi i fabrikës nuk pritet të shkaktojë ndikime negative në komunitetin lokal. Përkundrazi, aktiviteti ka potencial për të kontribuar në zhvillimin ekonomik dhe punësimin në zonë. |

| | |
|---|---|
| 8.Përshkrimi i metodave për vlerësimin e pasojave mjedisore | Metodat për vlerësimin e pasojave mjedisore janë të rëndësishme për menaxhimin dhe minimizimin e ndikimeve negative që mund të kenë projektet dhe aktivitetet në mjedis. Për të siguruar që një sistem menaxhimi mjedisor të jetë efektiv dhe të përmbushë standardet, përdoren disa metoda të caktuara që ndihmojnë në vlerësimin dhe monitorimin e ndikimeve. Ja disa nga këto metoda të përdorura për vlerësimin e pasojave mjedisore:<br>➢ **Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore (VNM)**<br>Vlerësimi i Ndikimeve Mjedisore është një metodë që shqyrton ndikimet e mundshme të një projekti në mjedis para se të fillojë ai. Ky proces përfshin:<br>▪ Studimi dhe Analiza: Identifikimi i ndikimeve potenciale dhe vlerësimi i efekteve të mundshme mbi ajrin, tokën, ujin, florën dhe faunën.<br>▪ Raportimi: Krijimi i një raporti të detajuar që përmbledh gjetjet dhe rekomandimet për masat e zbutjes.<br>▪ Konsultimi: Angazhimi i palëve të interesuara dhe publikimit të raportit për të marrë feedback dhe për të siguruar transparencë.<br>➢ **Sistemi i Menaxhimit të Mjedisit (SMM)**<br>Një Sistem i Menaxhimit të Mjedisit është një metodë sistematike për të menaxhuar dhe kontrolluar ndikimet mjedisore të një organizate. Ky sistem përfshin:<br>▪ Planifikimi: Identifikimi i ndikimeve dhe krijimi i planeve për të përmbushur kërkesat mjedisore.<br>▪ Implementimi: Zbatimi i politikave dhe procedurave për të menaxhuar ndikimet mjedisore.<br>▪ Kontrolli dhe Monitorimi: Monitorimi i përformancës mjedisore dhe auditimi për të siguruar përputhshmërinë me standardet dhe rregulloret.<br>Përmirësimi: Rishikimi dhe përmirësimi i procedurave për të përmirësuar përformancën mjedisore. |

- **Analiza e Ciklit të Jetës (ACJ)**

Analiza e Ciklit të Jetës shqyrton ndikimet mjedisore të një produkti gjatë të gjithë ciklit të tij, nga ekstraktimi i lëndëve të para deri në përdorim dhe asgjësim. Ky proces përfshin:

  - Hulumtimi i Ndikimeve: Vlerësimi i ndikimeve gjatë fazave të ndryshme të ciklit të jetës së produktit.
  - Krahasimi: Krahasimi i ndikimeve të ndryshme për të identifikuar mundësitë për përmirësim.
  - Raportimi: Krijimi i një raporti që tregon ndikimet dhe rekomandimet për përmirësim.

- **Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore (SNASh)**

Studimi i Ndikimeve Ambientale dhe Shëndetësore shqyrton ndikimet e një projekti jo vetëm në mjedis, por edhe në shëndetin e njeriut. Ky studim përfshin:

  - Analiza e Rrezikut për Shëndetin: Vlerësimi i rreziqeve të mundshme për shëndetin nga ndotja dhe ekspozimi ndaj substancave të dëmshme.
  - Studimi i Efekteve në Komunitet: Analiza e ndikimeve në cilësinë e jetesës dhe shëndetin e komunitetit përreth.

- **Analiza e Rrezikut Ambientale**

Analiza e Rrezikut Ambientale fokusohet në identifikimin dhe vlerësimin e rreziqeve që një projekt mund të sjellë për mjedisin. Ky proces përfshin:

  - Identifikimi i Rreziqeve: Përcaktimi i mundësive dhe probabilitetit të ndodhisë së incidenteve ndotëse.
  - Vlerësimi i Pasojave: Analiza e pasojave për ambientin në rast të ndodhisë së këtyre incidenteve.

| | |
|---|---|
| 9.Pershkrimi i masave | Sipas analizës së bërë mbi ndikimet e mundshme nga veprimtaria e fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit, si dhe në bazë të vlerësimit të projektit dhe rekomandimeve të dhëna në këtë raport, fabrika e kompanisë **"ANOR" Sh.P.K.**, me ushtrimin e veprimtarisë së saj në mënyrë të vazhdueshme në lokacionin e paraparë, nuk paraqet rrezik për mjedisin, pasi që do të respektojë të gjitha rekomandimet dhe do tu përmbahet pas marrjes së Pëlqimit Mjedisor. Me qëllim të zvogëlimit të mëtejmë të ndikimeve potenciale negative në mjedis, rekomandohet ndërmarrja e masave të cilat bëjnë pjesë në domenin e menaxhimit të rrezikut, si në rrethana të zakonshme ashtu edhe në ato të jashtëzakonshme. |
| 9.1. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ajër | Për të siguruar që aktivitetet e fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit të kompanisë **"ANOR" SH.P.K.** të zhvillohen në përputhje me standardet mjedisore dhe për të minimizuar ndikimet e mundshme në cilësinë e ajrit, janë përcaktuar një sërë masash parandaluese dhe korrigjuese. Këto masa ndahen sipas fazave të projektit, duke filluar nga ndërtimi i objektit e deri te funksionimi i tij gjatë periudhës operative. Zbatimi i tyre synon të kufizojë ndotjen nga pluhuri, emetimet e gazrave, si dhe ndikimet e shkaktuara nga përdorimi i qymyrit për ngrohje dhe lëvizja e mjeteve transportuese. Masat kryesore janë si vijojnë:<br>➢ **Gjatë fazës së ndërtimit të objekteve shtesë:**<br>• Ujitja e sipërfaqeve të ekspozuara për të reduktuar pluhurin.<br>• Përdorimi i mjeteve dhe makinerive ndërtimore me standarde të përshtatshme të emisioneve.<br>• Organizimi i transportit dhe planifikimi i qarkullimit për të shmangur grumbullimet dhe trafikun e panevojshëm.<br>• |

| | |
|---|---|
| | ➢ **Gjatë fazës operative:**<br>• Përdorimi i qymyrit me cilësi të lartë dhe me përmbajtje të ulët squfuri për ngrohje gjatë dimrit.<br>• Instalimi i filtrave(me karbon aktiv) për reduktimin e pluhurave që krijohen nga djegia e qymyrit.<br>• Mirëmbajtja e rregullt e sistemeve të ngrohjes për të siguruar efikasitet maksimal dhe reduktim të emetimeve.<br>• Përdorimi i karburanteve cilësore për automjetet transportuese.<br>• Kontrolli periodik teknik i mjeteve transportuese për të ulur emetimet difuze.<br>• Menaxhimi i qarkullimit të automjeteve për të shmangur ngarkesat e panevojshme dhe për të reduktuar ndotjen lokale të ajrit. |

<table>
<tr>
<td>9.3. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në ujë</td>
<td>
Për të siguruar që aktivitetet e fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit të kompanisë “ANOR” SH.P.K. të mos shkaktojnë ndotje të burimeve ujore, janë paraparë masa parandaluese dhe korrigjuese si gjatë fazës së ndërtimit ashtu edhe gjatë fazës operative. Zbatimi i këtyre masave garanton që ndikimet potenciale të mbeten minimale dhe në përputhje me standardet ligjore mjedisore.<br>
Gjatë fazës së ndërtimit të objekteve shtesë:
<ul>
<li>Përdorimi i ujit vetëm për qëllime teknike (kontrolli i pluhurit, pastrimi i mjeteve dhe sipërfaqeve).</li>
<li>Parandalimi i rrjedhjeve aksidentale të karburanteve dhe vajrave nga makineritë ndërtimore përmes kontrollit dhe mirëmbajtjes së tyre.</li>
<li>Përdorimi i zonave të përcaktuara për depozitimin e materialeve ndërtimore dhe mbetjeve, për të shmangur kontaktin me ujërat e shiut dhe rrjedhjen e tyre në tokë.</li>
</ul>
Gjatë fazës operative:
<ul>
<li>Funksionimi i rregullt i impiantit të trajtimit të ujërave të ndotura, i cili siguron pastrimin e ujit përpara shkarkimit në rrjetin e kanalizimit publik.</li>
<li>Monitorimi periodik i cilësisë së ujërave të trajtuara për të garantuar përputhshmëri me parametrat e lejuar.</li>
</ul>
Kontrolli i rregullt i automjeteve transportuese për të parandaluar rrjedhjet aksidentale të karburanteve dhe vajrave.<br>
<br>
Figura 8. Skica e Procesit te Impiantit për trajtimin e ujerave
</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| 9.4. Masat për mbrojtje nga zhurma | Zhurma përbën një nga ndikimet më të zakonshme që mund të shfaqet gjatë fazës së punëve operacionale të fabrikës së prodhimit të produkteve nga qumështit nga kompania **"ANOR" SH.P.K.**. Edhe pse niveli i pritur i zhurmës nuk konsiderohet i lartë dhe nuk paraqet rrezik serioz për popullatën sepse fabrika ndodhet në zone industrial kurse popullata jan larg me shtëpi banimi, megjithatë është e domosdoshme ndërmarrja e masave mbrojtëse për të siguruar pajtueshmërinë me standardet mjedisore dhe për të mbrojtur cilësinë e jetesës së banorëve në zonën përreth. Për këtë arsye, janë paraparë masat në vijim:<br>• Kufizimi i orarit të punimeve gjatë fazës së ndërtimit edhe të objekteve përcjellëse, duke shmangur kryerjen e punëve me nivel të lartë zhurme në orët e natës.<br>• Mirëmbajtja e rregullt e makinerive ndërtimore dhe mjeteve transportuese, në mënyrë që të reduktohet prodhimi i zhurmës së panevojshme.<br>• Përdorimi i pajisjeve me izolim akustik brenda ambienteve të mbyllura të fabrikës, kur është e nevojshme.<br>• Organizimi i qarkullimit të mjeteve transportuese, për të shmangur grumbullimin e tyre dhe krijimin e zhurmës shtesë në zonat e afërta me vendbanime.<br>• Monitorimi periodik i niveleve të zhurmës në perimetrin e objektit, për të siguruar respektimin e standardeve ligjore dhe mjedisore. |
| 9.5. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në peizazh, florë dhe faunë | Për të siguruar që ndikimet e fabrikës së produkteve nga qumështit në peizazh, florë dhe faunë të jenë sa më të kufizuara dhe të menaxhueshme, parashihen disa masa parandaluese dhe kompensuese, të cilat do të kontribuojnë në ruajtjen e vlerave mjedisore dhe përmirësimin e estetikës së zonës. Këto masa përfshijnë:<br>• Mbjellja e drunjtëve dekorativë, shkurreve dhe bimësisë së përshtatshme në zonat e hapura të fabrikës, në mënyrë që të përmirësohet cilësia vizuale e ambientit dhe të krijohet një mjedis më i |

| | |
|---|---|
| | këndshëm dhe natyror.<br>• Gjatë ndërtimit, kufizimi i punimeve vetëm brenda parcelës së projektuar dhe shmangia e dëmtimit të florës përreth që nuk ndikohet drejtpërdrejt nga projekti.<br>• Reduktimi i shqetësimeve për faunën përreth përmes përdorimit të pajisjeve të mirëmbajtura.<br>• Sigurimi që aktivitetet e ndërtimit dhe operimit të mos shkaktojnë ndotje të drejtpërdrejtë apo të tërthortë në habitatet natyrore, duke marrë parasysh distancën e fabrikës nga flora e mbrojtur (1.73 km).<br>• Mirëmbajtja periodike e gjelbërimit dhe rregullimi i hapësirave të jashtme, për të kontribuar në një mikroklimë më të përshtatshme dhe për të siguruar mbrojtje natyrore ndaj pluhurit dhe zhurmës. |

<table>
<tr>
<td>9.6. Masat për zvogëlimin e ndikimeve në vendbanime dhe popullatë</td>
<td>Për të siguruar që aktivitetet e ndërtimit dhe ato operative të fabrikës të mos shkaktojnë ndikime të konsiderueshme në vendbanimet dhe popullatën përreth, është e domosdoshme zbatimi i një sërë masash parandaluese dhe zbutëse. Këto masa kanë për qëllim të reduktojnë shqetësimet e mundshme që lidhen kryesisht me qarkullimin e mjeteve transportuese, emetimet akustike dhe ruajtjen e cilësisë së jetës së komunitetit lokal.<br>Masat kryesore përfshijnë:<br>• Orari i lëvizjes së mjeteve transportuese do të organizohet në mënyrë që të shmangen periudhat e pikut të qarkullimit dhe të reduktohen shqetësimet për banorët.<br>• Automjetet që përdoren për furnizim dhe shpërndarje do të jenë në gjendje të mirë teknike, me qëllim uljen e emisioneve të gazrave dhe zhurmës.<br>• Kompania do të mbajë komunikim të rregullt me komunitetin lokal për t'i informuar mbi aktivitetet dhe për të adresuar çdo shqetësim të mundshëm.<br>• Do të realizohet monitorim i rregullt i ndikimeve mbi mjedisin e afërt dhe mbi cilësinë e jetës së popullatës, në mënyrë që çdo devijim i mundshëm të korrigjohet në kohë.</td>
</tr>
</table>

| | |
|---|---|
| 9.7. Masat për menaxhimin e mbeturinave | Gjatë operimit të fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit nga kompania **"ANOR" SH.P.K.**, pritet të krijohen sasi të kufizuara mbeturinash. Këto mbeturina do të jenë kryesisht të natyrës komunale, të gjeneruara si gjatë procesit teknologjik, ashtu edhe nga aktivitetet e përditshme të punëtorëve.Të gjitha mbeturinat do të depozitohen në kontejnerë të posaçëm, të mbuluar dhe të vendosur në hapësira të përcaktuara brenda kompleksit, duke siguruar parandalimin e shpërndarjes së tyre dhe shmangien e ndotjes së mjedisit. Për largimin e mbeturinave komunale, do të përkujdeset kompania komunale "BIFURKACIONI", e cila do kujdeset për bartjen e mbeturinave, ujërave fekale, ujit të papastër, mirëmbajtjes se kanalizimit, mirëmbajtjes dimërore etj., me te cilën kompania "ANOR" ka marrëveshje me ketë kompani qe nga janari i viti 2025. Kjo kompani do të   kryejë transportin dhe menaxhimin e mbeturinave në përputhje me kërkesat ligjore dhe standardet mjedisore në fuqi.<br>*Foto 9 kontajner për mbeturina* |

### 9.8. Masat rehabilituese

Në rast të mbylljes eventuale të fabrikës për prodhimin e produkteve nga qumështit nga kompania **“ANOR” SH.P.K.**, parashihen masa të veçanta rehabilituese të cilat sigurojnë që ndërprerja e aktivitetit të mos shkaktojë pasoja të qëndrueshme mbi mjedisin. Procesi i rehabilitimit parashihet të zhvillohet në disa faza të ndërthurura logjikisht, të cilat përshkruhen më poshtë:

**1. Faza e çmontimit dhe largimit të pajisjeve**

- Pajisjet teknologjike, mjetet ndihmëse dhe instalimet do të çmontohen në mënyrë të kontrolluar dhe do të dërgohen në kompani të licencuara për riciklim ose trajtim.
- Materialet e riciklueshme (metal, plastikë, qelq) do të ndahen sipas kategorive dhe do të përpunohen në qendrat përkatëse.
- Pajisjet që nuk janë të riciklueshme do të dorëzohen në deponi të licencuara për mbeturina industriale.

**2. Faza e menaxhimit të mbeturinave**

- Të gjitha mbeturinat e krijuara nga procesi i mbylljes do të klasifikohen sipas **Katalogut Shtetëror të Mbeturinave**.
- Mbeturinat komunale dhe ato nga punëtorët do të grumbullohen në kontejnerë të veçantë dhe do të tërhiqen nga kompania e pastrimit “BIFURKACIONI”.
- Mbeturinat ndërtimore dhe inerte nga çmontimi i objekteve do të transportohen dhe depozitohen në lokacione të miratuara nga autoritetet komunale.

**3. Faza e pastrimit dhe dekontaminimit**

- Sipërfaqet e brendshme dhe të jashtme të objektit do të pastrohen në mënyrë të plotë, për të shmangur mbetjet e materialeve të rrezikshme ose substancave ndotëse.
- Do të bëhet kontroll i veçantë i tokës për të identifikuar ndotjet e mundshme nga derdhjet aksidentale të karburanteve apo vajrave gjatë periudhës së funksionimit.
- Në rast të ndotjeve të konstatuara, do të merren masa për dekontaminim dhe rehabilitim të menjëhershëm.

| | |
|---|---|
| | • <br>**4. Faza e rikultivimit të hapësirës**<br>• Sipërfaqet e liruar pas çmontimit do të rrafshohen dhe do të përshtaten për përdorime të reja ekonomike ose për rikthim në natyrë.<br>• Do të realizohet mbjellja e gjelbërimit me bimësi vendore, duke përfshirë pemë dekorative dhe barishte që përmirësojnë cilësinë vizuale të peizazhit.<br>• Kjo masë synon jo vetëm rikthimin estetik të zonës, por edhe përforcimin e rolit ekologjik për biodiversitetin lokal.<br>**5. Monitorimi pas mbylljes**<br>• Pas përfundimit të masave rehabilituese, do të zhvillohet një periudhë monitorimi për të siguruar që nuk ka mbetje ndotjeje në tokë, ujëra ose ajër.<br>• Monitorimi do të kryhet në bashkëpunim me autoritetet kompetente komunale dhe ministrinë përkatëse të mjedisit |

| | |
|---|---|
| 9.9 Komponentë (Kusht)mjedisore, potenciali për ndikim, veprimet që shkaktojnë ndikimet dhe masat për parandalimin e këtyre ndikimeve | (see table below) Në këtë tabelë jan paraqitur të gjitha mundësit potenciale të mjedisit, duke dhënë një qasje të detajuar mbi potencialet për ndikim, burimet e këtyre ndikimeve dhe masat që duhet të merren për parandalimin e tyre. |
| 10.Përshkrimi i | Fabrikat e djathit, si shumë industri të tjera, mund të shkaktojnë pasoja negative mjedisore në disa |

| Komponenti mjedisore | Potenciali për ndikim negativ | Veprimi që shkakton ndikimin | Masat që duhet të ndërmerren |
|---|---|---|---|
| **Ajri** | Emisione të pluhurit dhe gazrave gjatë transportit dhe përdorimit të qymyrit për ngrohje | Transporti i lëndëve të para dhe produkteve, djegia e qymyrit gjatë periudhës së dimrit | -Përdorimi i karburanteve cilësore dhe mirëmbajtja e automjeteve<br>- Instalimi i filtrave për reduktimin e emisioneve nga qymyri<br>- Organizimi i orareve të transportit për të shmangur trafikun intensiv<br>- Monitorim periodik i cilësisë së ajrit |
| **Uji dhe Toka** | Potencial për ndotje nga rrjedhjet aksidentale të karburanteve Degradim i përkohshëm gjatë ndërtimit dhe ndotje nga deponimi jo i rregullt i mbeturinave | Rrjedhjet e vajrave dhe karburanteve nga automjetet ose makineritë;<br>Punimet ndërtimore, lëvizja e makinerive dhe deponimi i mbetjeve | - Menaxhimi i kujdesshëm i substancave teknike dhe karburanteve<br>- Monitorim periodik i parametrave të ujit sipas standardeve<br>- Përdorimi i hapësirës vetëm sipas planit ndërtimor<br>- Deponimi i mbeturinave në kontejnerë të dedikuar dhe të mbuluar<br>- Marrëveshje me kompani të licencuar për largimin e mbeturinave<br>- Rehabilitimi i hapësirave të lira me gjelbërim pas ndërtimit |
| **Natyra dhe biodiversiteti (flora dhe vegjetacioni, fauna, Zonat e mbrojtura të natyrës)** | Ndikim minimal, për shkak të distancës nga zonat me vlerë ekologjike | Zhvillimi i objektit në zonë industriale dhe pranë tokave të kultivuara | - Ruajtja e gjelbërimit ekzistues në periferi të objektit<br>- Mbjellja e bimësisë dekorative dhe funksionale për të rritur vlerën ekologjike të hapësirës<br>- Monitorimi i periodik i biodiversitetit përreth zonës |
| **Zhurma** | Potencial minimal | Ka potenciale të voglë të shkaktimit të zhurmë pasi aktiviteti zhvilloreh mbrenda | Mirëmbajtja e pajisjeve, përdorimi i automjeteve me standarde akustike. |
| **Shëndeti i qytetareve dhe konsumatorëve** | Potencial minimal | Në kushte jo të duhura mirëmbajtjes se hapësirës manipuluese. | Të gjitha pajisjet të cilat mund të kenë ndikime në shëndetin e qytetareve do t'iu kushtohet rëndësi e veçan në mirëmbajtjen e tyre |

| | |
|---|---|
| pasojave negative mjedisore | mënyra. Disa nga këto pasojat përfshijnë:<br><br>1. **Konsumi i Lartë i Ujit**: Prodhimi i djathit kërkon sasi të mëdha uji, nga proceset e pastrimit deri te ndihmat për xhelatinë dhe përgatitjen e qumështit. Kjo mund të çojë në shterimin e burimeve të ujit në zonat përreth.<br>2. **Ndotja e Ujit**: Uji i përdorur në procesin e prodhimit shpesh përmban substanca të dëmshme, si detergjente dhe substanca kimike, që mund të ndotë lumenjtë dhe burimet e ujit të pijshem nëse nuk trajtohet siç duhet.<br>3. **Emisionet e Gazrave Ndotës**: Prodhimi i djathit përfshin procese që mund të shkaktojnë aroma të pakëndëshme për mjedisin |
| 11.Monitorimi dhe raportimi | **Monitorimi** i ndikimeve mjedisore është një proces kyç për menaxhimin e aktiviteteve industriale të fabrikës së përpunimit të produkteve nga qumështit. Është i domosdoshëm për të siguruar që puna prodhuese e fabrikës së kompanisë **"ANOR" SH.P.K.** nuk dëmtojnë mjedisin. Punët operacionale të fabrikës kërkojnë një monitorim të vazhdueshëm dhe të sistematizuar nga jerëz profesional të treguesve mjedisorë, përfshirë cilësinë e ajrit, ujit dhe tokës. Kjo ndihmon në identifikimin e shpejtë të ndotësve dhe të ndikimeve negative që mund të ndodhin gjatë fazës operative.<br>Produktet dhe ndikimet në mjedis do të kontrollohen rregullisht për të siguruar përputhje me standardet e caktuara dhe me legjislacionin përkatës. Çdo rast i ndotjes ose shkeljes së standardeve do të trajtohet me seriozitet. Nëse identifikohen ndikime negative, do të merren masat e nevojshme për të adresuar situatën, përfshirë ndalimin e aktiviteteve që shkaktojnë ndotje dhe implementimin e masave të zbutjes. Çdo rast i ndotjes që tejkalon normat e lejuara do t'i raportohet organeve kompetente, në përputhje me ligjet e aplikueshme, për të siguruar transparencën dhe përgjegjshmërinë. |

| | |
|---|---|
| 12.Përfundim | Vlerësimi i Ndikimit në Mjedis për fabrikën e prodhimit të produkteve nga qumështit nga kompania **"ANOR" SH.P.K.** ka evidentuar se aktivitetet operative të planifikuara kanë një potencial minimal për ndikime negative mbi komponentët kryesorë mjedisorë, duke përfshirë ajrin, ujërat, tokën, biodiversitetin dhe komunitetin lokal. Proceset teknologjike kryhen brenda ambienteve të mbyllura industriale dhe përdorin pajisje moderne, gjë që zvogëlon ndjeshëm rrezikun e përhapjes së ndotësve dhe ndikon në menaxhimin e qëndrueshëm të mjedisit përreth. Ndikimet e identifikuara lidhen kryesisht me fazën operative të fabrikës dhe përfshijnë emetimet e kufizuara në ajër nga përdorimi i automjeteve dhe makinerive, mundësinë e rrjedhjeve aksidentale të vajrave dhe karburanteve që mund të prekin ujërat dhe tokën, si dhe nivelin e moderuar të zhurmës. Masat parandaluese, përdorimi i sistemeve të trajtimit të ujërave, menaxhimi i duhur i mbetjeve, si dhe monitorimi i proceseve industriale garantojnë që këto ndikime të jenë të menaxhueshme dhe të qëndrueshme brenda kufijve të lejuar ligjorë. Nga aspekti ekologjik, fabrikat nuk parashikohet të ndikojnë në mënyrë të konsiderueshme në florën dhe faunën lokale, për shkak të vendndodhjes së saj në një zonë industriale.<br><br>Gjithashtu, nga perspektiva sociale dhe ekonomike, fabrikëa ka potencial për të kontribuar në zhvillimin local, zbutjen e papunësisë përmes krijimit të vendeve të reja të punës dhe promovimit të praktikave të qëndrueshme në industrinë e qumështit. Duke marrë parasysh të gjitha këto aspekte, vlerësohet se informacioni i mbledhur është i mjaftueshëm për përgatitjen e Raportit të Vlerësimit të Ndikimit në Mjedis. Si rezultat, rekomandohet që institucionet kompetente, përkatësisht Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor (MMPH), të japin mendimin pozitiv për dhënien e Pëlqimit Mjedisor për projektin e fabrikës **"ANOR" Sh.P.K.**, duke siguruar kështu realizimin e aktivitetit në përputhje me standardet mjedisore dhe kërkesat ligjore. |

<table>
<tr>
<td>13. Raportimi</td>
<td>Raportimi është një proces i rëndësishëm që siguron informacion të detajuar mbi gjendjen e mjedisit dhe ndikimet e aktiviteteve të fabrikës. Raportimi do të kryhet nga një individ i autorizuar nga menaxheri i kompanisë. Ky person do të jetë përgjegjës për mbledhjen dhe analizimin e të dhënave, si dhe për përgatitjen e raporteve periodike.<br>Në raport do të përfshihen të dhëna të detajuara për monitorimin e parametrave mjedisorë që kërkohen në Pëlqimin Mjedisor, i cili lëshohet nga Ministria e Mjedisit, Planifikimit Hapësinor dhe Infrastrukturës (MMPH). Këto të dhëna mund të përfshijnë: Emisionet e gazrave ndotës, Cilësia e ujit dhe ndotësit në ujërat e shkarkuara dhe Parametrat e cilësisë së tokës.<br>Në raport, gjithashtu do të përfshihen të dhënat për monitorimin e të gjithë parametrave që do të përcaktohen në Lejen Mjedisore (që lëshohet pasi kompania të pajiset me Pëlqim Mjedisor nga MMPH).<br>Tabela-4 Kostoja investive e fabrikës</td>
</tr>
<tr>
<td>14.Kostoja investive</td>
<td>
<table>
<tr><th colspan="3">KOSTO INVESTIVE PËR FABRIKEN E PRODUKTEVE NGA QUMËSHTIT NGA KOMPANIA “ANOR” SH.P.K.</th></tr>
<tr><td>1</td><td>Ndërtimi i Objektit p(I marrur me qera)</td><td>---------- €</td></tr>
<tr><td>2</td><td>Makineritë e reja për prodhimin e produkteve te qumështit</td><td>155,000.00 €</td></tr>
